



PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM- PAI

Pasqyrat Financiare Vjetore dhe Raporti i Auditorit të Pavarur

1 Janar 2021 - 31 Dhjetor 2021

Përmbajtja:

| | |
|--|------|
| Raport i auditorëve të Pavarur.. | 3-5 |
| Pasqyra e Pozitës Financiare..... | 6 |
| Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve..... | 7 |
| Informata të përgjithshme | 8 |
| Shënimet e pasqyrave financiare..... | 9-13 |

Raport i Auditorëve të Pavarur

Drejtuar Kryesisë PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM

Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike

Mohim i Opinionit

Ne kemi qenë të angazhuar për të audituar raportet financiare të bashkëngjitura të Subjektit Politik “PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM” (në vijim referuar si “Subjekti Politik” apo “PAI”), të përbëra nga Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 Dhjetor 2021, Pasqyra e të Hyrave dhe Shpenzimeve për periudhën e përfunduar me këtë datë, dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshira në faqen 9-13.

Ne nuk shprehim një opinion mbi raportet financiare të vitit 2021 të subjektit politik “PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM”. Për shkak të rëndësisë së çështjeve të përshkruara në paragrafin bazat për mohim të opinionit, ne nuk kemi qenë në gjendje të sigurojmë evidencën e nevojshme dhe të mjaftueshme të auditimit për të patur një bazë për një opinion të auditimit.

Bazat për Mohim të Opinionit

- Subjekti Politik nuk ka plotësuar drejt pasurinë, ekuitetin dhe detyrimet me 31 Dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020, po ashtu shënimet e prezantuara në Pasqyrat Financiare nuk mbështeten me dëshmi relevante lidhur me zërat e pasqyrave financiare të SP me 31 Dhjetor 2021 ashtu siç kërkohet me ligjin Nr. 04/L-212 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuara dhe plotësuara me ligjin Nr. 04/L-058, Neni 15 Raportimi Financiar. Duke pasur parasysh natyrën e shënimeve që mban subjekti politik, ne e kishim të pamundur të përcaktojmë korrigjimet e nevojshme me 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020.
- Subjekti politik nuk ka ofruar dëshmi mbështetëse për të hyrat dhe shpenzimet e prezantuara për periudhën 01 Janar 2021 deri me 31 Dhjetor 2021 prandaj ne nuk ishim në gjendje të japim një opinion në lidhje me të hyrat dhe shpenzimet e njohura në pasqyrën e të ardhurave apo pajtueshmërinë e tyre me ligjin Nr. 04/L-212 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuara dhe plotësuara me ligjin Nr. 04/L-058. Për më tepër të hyrat e deklaruara në vitin 2021 janë të mbivlerësuara për vlerën 31,500.00 Euro.
- Te hyrat e prezantuara tek kategoria e “Te hyrave nga fushata” dhe shpenzimet e prezantuara tek kategoria “Shpenzimet e fushatës” nuk përputhen me shënimet e deklaruara në raportin financiar të fushatës.

Theksim i çështjes

Ne po ashtu tërheqim vëmendjen në lidhje me gjetjet e mëposhtme:

- Subjekti Politik nuk ka mirëmbajtur një kontabilitet të mirëfilltë për të mundësuar regjistrimin e transaksioneve financiare dhe përgatitjen e pasqyrave financiare sipas kërkesave të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit të aplikueshme në Kosovë.
- Subjekti Politik nuk ka të definuar me Statut, mundësinë e ushtrimit të kontrollit të brendshëm financiar të saj dhe të drejtën e anëtarëve për t’u informuar për të gjitha të

hyrat dhe shpenzimet e subjekteve politike si dhe për përgjegjësinë e organit gjegjës për transaksionet financiare, ashtu siç parashihet në ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 17 Kontrolli i Brendshëm.

- Subjekti Politik nuk ka respektuar kërkesat ligjore në lidhje me publikimin e raporteve financiare vjetore dhe të fushatës sipas ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar, paragrafi 5.1 dhe 5.2.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre të ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitet sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.

- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audit & Conto sh.p.k

Muhamet Feka
Auditor Ligjor
18 Tetor 2023

PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM-PAI*Shënimet për Pasqyrat Financiare 1 Janar 2021 deri më 31 Dhjetor 2021***Pasqyra e Pozitës Financiare**

| Pasuritë | | Me 31 Dhjetor 2021 | Me 31 Dhjetor 2020 |
|--|---------|---------------------------|---------------------------|
| Pasuritë afatgjata | Shënimi | Shuma në Euro | Shuma në Euro |
| Toka, objektet dhe pajisjet | 5 | 0.00 | 0.00 |
| Pasuritë e paprekshme | | 0.00 | 0.00 |
| Pasuritë tjera afatgjata | 6 | 0.00 | 0.00 |
| Total pasuritë afatgjata | | 0.00 | 0.00 |
| Pasuritë afatshkurtra | | | |
| Llogaritë e arkëtueshme | | | |
| Parapagimet | | | |
| Paraja dhe ekuivalentët e parasë | 7 | 106.00 | 106.12 |
| Pasuritë tjera afatshkurtra | | 0.00 | 0.00 |
| Total pasuritë afatshkurtra | | 106.00 | 106.12 |
| Total pasuritë | | 106.00 | 106.12 |
| Ekuiteti | | | |
| Fondet e akumuluar | | | 106.12 |
| Suficiti / (deficiti) i vitit | | | 106.12 |
| Total Ekuiteti | | | 212.24 |
| Detyrimet | | | |
| Detyrimet afatgjata | | | |
| Huatë e pagueshme | | 0.00 | 0.00 |
| Të hyrat e shtyera | | 0.00 | 0.00 |
| Gjithsej detyrimet afatgjata | | 0.00 | 0.00 |
| Detyrimet afatshkurtra | | | |
| Llogaritë e pagueshme dhe të tjera | 8 | 0.00 | 0.00 |
| Huatë e pagueshme | | 0.00 | 0.00 |
| Detyrimet tjera afatshkurtra | 9 | 0.00 | 0.00 |
| Gjithsej detyrimet afatshkurtra | | 0.00 | 0.00 |
| Gjithsej detyrimet | | 0.00 | 0.00 |
| | | | |
| Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet | | 0.00 | 212.24 |

PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM-PAI*Shënimet për Pasqyrat Financiare 1 Janar 2021 deri më 31 Dhjetor 2021***Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve**

| | Shënimi | Viti që përfundon me 31 Dhjetor | |
|--|----------|---------------------------------|------------------|
| | | 2021 | 2020 |
| Të hyrat | | | |
| Të hyrat nga buxheti | | 31,500.00 | 31,500.00 |
| Të hyrat nga anëtarësia | | | 0.00 |
| Donacionet dhe kontributet në të holla | 3 | 31,500.00 | 0.00 |
| Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime | 4 | 0.00 | 0.00 |
| Të hyrat e fushatës | | 0.00 | 0.00 |
| Te hyrat e liruar nga te hyrat e shtyera | | 0.00 | 0.00 |
| Të hyrat tjera | | 0.00 | 0.00 |
| Gjithsej të hyrat për vitin | | 63,000.00 | 31,500.00 |
| Shpenzimet | | | |
| Pagat dhe kompensimet | 2 | 18,000.00 | 18,000.00 |
| Shpenzimet e transportit | 2 | 3,000.00 | 3,000.00 |
| Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat | 2 | 1,440.00 | 1,440.00 |
| Shpenzimet e fushatës | 2 | 0.00 | 0.00 |
| Blerja e mallrave | 2 | 1,300.00 | 1,200.00 |
| Shpenzimet e përgjithshme | 2 | 3,900.00 | 3,900.00 |
| Shpenzimet e ndryshme | 2 | 3,858.20 | 3,853.88 |
| Gjithsej shpenzimet për vitin | | 31,498.20 | 31,393.88 |
| Suficiti / (deficiti) për vitin | | 31,501.80 | 106.12 |

PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM-PAI

Shënimet për Pasqyrat Financiare 1 Janar 2021 deri më 31 Dhjetor 2021

1. Informata të Përgjithshme

PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM - PAI

Udhëheqja: Hetem Arifi (Kryetar i partisë)
Përfaqësues i autorizuar financiar – Rahman Kadriu

Selia e partisë: Rruga Shqipëria p.n .Lipjan.

Pasqyrat financiare të SP PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM -PAI nuk janë përgatitur sipas kërkesave të Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar.

Bazuar në nenin 19 paragrafi 2 pika 7 e Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 „Subjekti i regjistruar politik brenda pesë (5) ditëve të punës nga marrja e draft raporteve të audituara mund ta dorëzojë raportin e rishikuar financiar dhe shpjegimet lidhur me gabimet ose lëshimet të identifikuar nga auditorët.

Subjekti Politik mirëmbanë llogari kryesore bankare në bankën RBKO.

PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM-PAI*Shënimet për Pasqyrat Financiare 1 Janar 2021 deri më 31 Dhjetor 2021***Shënimi 2. Shpenzimet**

| Shpenzimet | Shpenzimi në Euro | Pagesa në Euro | Borxhi i mbetur në Euro |
|---|------------------------------|---------------------------|------------------------------------|
| Pagat dhe kompensimet | | | |
| Pagat dhe kompensimet, neto | 18,000.00 | 18,000.00 | 0.00 |
| Kontributet pensionale të punëmarrësit | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Kontributet pensionale të punëdhënësit | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Tatimet në të ardhura personale | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Beneficionet tjera | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Gjithsej | 18,000.00 | 18,000.00 | 0.00 |
| Shpenzimet e transportit | | | |
| Automjetet motorike të huazuara | 3,000.00 | 3,000.00 | 0.00 |
| Karburantet | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Biletat, aeroplanit/autobusit/trenit/taksit etj. | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Sigurimi dhe mirëmbajtja e veturave | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Çdo shpenzim tjetër i transportit | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Gjithsej shpenzimet e transportit | 3,000.00 | 3,000.00 | 0.00 |
| Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat | | | |
| Lokali | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Ushqimi | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Aktivitete kulturore dhe rekreative | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Radio dhe spotet televizive | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Stendat e afishmit dhe reklamimet në gazeta | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Shpenzimet tjera të reklamave, reprezentacionit dhe konferencave | 1,440.00 | 1,440.00 | 0.00 |
| Gjithsej reklammat, reprezentacioni dhe konferencat | 1,440.00 | 1,440.00 | 0.00 |
| Shpenzimet e fushatës | | | |

PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM-PAI*Shënimet për Pasqyrat Financiare 1 Janar 2021 deri më 31 Dhjetor 2021*

| | | | |
|--|------------------|----------------------|----------------------|
| Shpenzimet e fushatës | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Gjithsej shpenzimet e fushatës | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Blerja e mallrave | | | |
| Furnizimi i zyrës | 1,200.00 | 1,200.00 | 0.00 |
| Pajisjet të vogla | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Gjithsej blerja e mallrave | 1,200.00 | 1,200.00 | 0.00 |
| Shpenzimet e përgjithshme | | | |
| Qiraja e lokalit të zyrës | 6,105.00 | 6,105.00 | 0.00 |
| Telefoni, interneti dhe posta | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat) | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Shpenzimet e zhvlerësimit të pasurisë afatgjatë | | //////////////////// | //////////////////// |
| Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet në natyrë në mallra dhe shërbime | | //////////////////// | //////////////////// |
| Gjithsej shpenzimet e përgjithshme | 6,105.00 | 6,105.00 | 0.00 |
| Shpenzimet e ndryshme | | | |
| Mirëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| Shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjetër | 1,753.00 | 1,753.00 | 0.00 |
| Gjithsej shpenzimet e ndryshme | 1,753.00 | 1,753.00 | 0.00 |
| Gjithsej shpenzimet | 31,498.00 | 31,498.00 | 0.00 |

PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM-PAI*Shënimet për Pasqyrat Financiare 1 Janar 2021 deri më 31 Dhjetor 2021***Shënimi 3: Donacionet dhe kontributet në të holla**

| Pranuar nga | | | | Vlera | E pranuar përmes: | |
|--|--------|----------------|---------------------------------|-------------|-------------------|-------------|
| Kontribuesi | Adresa | Numri personal | Data kur është dhënë kontributi | në euro | Bankë | Arkë |
| KQZ ,buxheti | | | 2021 | | 31,500.00 | |
| | | | | | | |
| Gjithsej donacionet dhe kontributet në të holla | | | | 0.00 | 31,500.00 | 0.00 |

Shënimi 4: Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime

| Përshkrimi i mallit / shërbimit | Pranuar nga | | | | Vlera |
|--|-------------|--------|----------------|---------------------------------|-------------|
| | Kontribuesi | Adresa | Numri personal | Data kur është dhënë kontributi | në euro |
| | | | | | |
| Gjithsej kontributet në natyrë në mall dhe shërbime | | | | | 0.00 |

Shënimi 5: Toka, objektet dhe pajisjet

| | Bilanci në fillim të vitit (kosto historike) | Blerjet gjatë vitit | Zhvlerësimi i akumuluar | Zhvlerësimi i vitit | Bilanci në fundë të vitit (vlera neto) |
|---|--|---------------------|-------------------------|---------------------|--|
| Toka | | | | | 0.00 |
| Objektet | | | | | |
| Veturat | | | | | |
| Pajisjet e zyrës | | | | | |
| Pajisjet e teknologjisë informative | | | | | |
| Pajisjet tjera | | | | | |
| Gjithsej toka, objektet dhe pajisjet | | | | | 0.00 |

PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM-PAI*Shënimet për Pasqyrat Financiare 1 Janar 2021 deri më 31 Dhjetor 2021***Shenime tjera**

| Shënimi 6. Llogari të arkëtueshme | Me 31 Dhjetor 2021 Shuma në Euro | Me 31 Dhjetor 2020 Shuma në Euro |
|--|---|---|
|bleresi 1 | | |
|bleresi 2 | | |
| Gjithsej Llogarit e arkëtueshme | 0.00 | 0.00 |

| Shënimi 7. Paraja dhe ekuivalentët e parasë | Me 31 Dhjetor 2021 Shuma në Euro | Me 31 Dhjetor 2020 Shuma në Euro |
|--|---|---|
| Paraja në bankë | 106.00 | 106.12 |
| Paraja në arkë | 0.00 | 0.00 |
| | | |
| Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë | 106.00 | 106.12 |

| Shënimi 8. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera | Me 31 Dhjetor 2021 Shuma në Euro | Me 31 Dhjetor 2020 Shuma në Euro |
|--|---|---|
|furnitori 1 | | |
|furnitori 2 | | |
| Llogari te pagueshme te tjera | | |
| | | |
| Gjithsej llogaritë e pagueshme dhe të tjera | 0.00 | 0.00 |

| Shënimi 9. Detyrimet tjera afatshkurtra | Me 31 Dhjetor 2021 Shuma në Euro | Me 31 Dhjetor 2020 Shuma në Euro |
|--|---|---|
| Detyrimet për paga dhe tatime | | |
| Detyrimet për qira | | |
| Detyrimet për gjoba dhe ndëshkime | | |
| Detyrime tjera afatshkurtër (huazimet) | | |
| Gjithsej detyrimet tjera afatshkurtra | 0.00 | 0.00 |

PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM-PAI*Shënimet për Pasqyrat Financiare 1 Janar 2021 deri më 31 Dhjetor 2021*

Shënimi 10: Pagesat mbi 5,000.00 Euro

| | Pagar ndaj: | | | | Vlera |
|---|-----------------------|--------|----------------|----------------------------|-------------|
| Qëllimi i pagesës | Përsoni Fizik/Juridik | Adresa | Numri personal | Data kur është bërë pagesa | në euro |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| Gjithsej pagesat mbi 5,000.00 Euro | | | | | 0.00 |